

**V E N D I M**  
**Nr. 365, datë 14.7.2000**

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË SHKURTOHEN NGA RISTRUKTURIMI I  
INDUSTRIË SË BAKRIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr 8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Nuk vlerësohen sektorë me rëndësi të veçantë dhe t’u nënshtrohen procesit të privatizimit, mbylljes dhe likuidimit, duke filluar nga 1.7.2000, sektorët e poshtëshënuar të industrisë së bakrit.

|                                           |         |
|-------------------------------------------|---------|
| Miniera e bakrit, Krumë                   | Has     |
| Miniera e bakrit, Nikoliq 1               | Has     |
| Fabrika e pasurimit të bakrit, Golaj      | Has     |
| Miniera e bakrit, Qafë-Bari               | Pukë    |
| Miniera e bakrit , Fushë –Arrëz           | Pukë    |
| Parku i transportit Fushë-Arrëz           | Pukë    |
| Miniera e bakrit , Spaç                   | Mirditë |
| Miniera e bakrit, Gurth, Spaç 1           | Mirditë |
| Fabrika nr.1.e pasurimit të bakrit, Repts | Mirditë |
| Parku i transportit, Rrëshen              | Mirditë |
| Uzina e bakrit, Laç                       | Kurbën  |
| Miniera e bakrit, Rehovë                  | Korçë   |
| Fabrika e pasurimit të bakrit, Rehovë     | Korçë   |
| Impianti i boksive                        | Korçë   |
| Objektet e sh.a NNM Metalifere            | Tiranë  |

2. Për ruajtjen deri në privatizimin dhe likuidimin e plotë të aseteve të objekteve të mësipërme duhen 115 punonjës dhe 34 policë privatë, si dhe një fond pagë mujore prej 2 444 milionë lekësh në muaj, nga të cilat 16.15 milionë lekë për vitin 2000, përfshirë fondet për energji etj, fonde të cilat do të paguheshin nga buxheti i shtetit.

3. Sektorët e industrisë së bakrit, të cilët në rast investimi rezultojnë të frytshëm e me perspektivë dhe që do të mbahen në regjim të përkohshëm konservimi janë:

|                                            |         |
|--------------------------------------------|---------|
| Miniera e bakrit, Lak Rroshi               | Pukë    |
| Miniera e bakrit, Munellë                  | Pukë    |
| Fabrika e pasurimit të bakrit, Fushë-Arrëz | Pukë    |
| Miniera e bakrit, Karmë 2                  | Shkodër |
| Fabrika e pasurimit të bakrit, Mjedë       | Shkodër |
| Miniera e bakrit, Perlati jugor            | Mirditë |
| Fabrika e pasurimit të bakrit, Rrëshen     | Mirditë |
| Uzina e bakrit, Rubik                      | Mirditë |
| Impianti i skorjeve, Shëngjin              | Lezhë   |

4. Fondet e nevojshme për ruajtjen dhe konservimin e sektorëve të industrisë së bakrit, të cilët do të mbahen në regjim të përkohshëm konservimi, arrijnë vlerat e 2.88 milionë lekëve në muaj, prej të cilave 18.8 milionë lekë nevojiten për të mbyllur vitin 2000, përfshirë fonde për energji etj, fonde të cilat do të përballohen nga buxheti i shtetit.

5. Punonjësit që dalin të tepërt, si pasojë e privatizimit apo likuidimit të sektorëve të

industrisë së bakrit, por që deri më datën 1.6.2000 kanë qenë në marrëdhënie pune dhe që do të jenë të tillë deri në çastin e mbylljes së objekteve, të cituara në pikën 1 të këtij vendimi, të trajtohen për 1(një) vit me pagën minimale në shkallë vendi në çastin e hyrjes në fuqi të vendimit në fjalë.

6. Periudha 1(një) vjeçare e përmendur në pikën 5 të vendimit të njihet si vjetërsi pune, për efekt pensioni, dhe të shënohet e tillë në librezë.

7. Përfitojnë nga ky vendim ata punonjës të “industrisë së bakrit”, të cilët kanë qenë të punësuar pranë kësaj shoqërie pandërprerje, që nga data 1.6.1999 e deri në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit. Në rast të kundërt u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi. Po kështu, trajtimi sipas këtij vendimi u ndërpritet edhe atyre punonjësve që thirren për punë dhe nuk pranojnë të punojnë.

9. E drejta e trajtimit 1 (një ) vjeçar, me pagë minimale, sipas pikës 2 të këtij vendimi u njihet edhe atyre punonjësve që shkëputen nga ky trajtim për të punuar për një periudhë jo më shumë se 1(një) vit në sektorin e bakrit, ku ata kanë punuar më parë.

10. Fondi prej 12.31 milionë lekësh në muaj (74 milionë për vitin 2000 dhe 74 milionë lekë për vitin 2001), për trajtimin e punonjësve që humbasin vendin e punës si pasojë e ristrukturimit të industrisë së bakrit, që përfshihen në këtë vendim, do të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, i vitit 2000, i cili i jepet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Për vitin 2001 fondi të parashikohet në buxhetin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

11. Pagesa e Punonjësve që dalin të tepërt nga zbatimi i këtij vendimi do të bëhet nga zyrat e punës në rrethet përkatëse.

12. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**